

AKT NORMATIV
Nr. 2, datë 2.5.2013

PËR RIVLERËSIMIN E PASURISË SË PALUAJTSHME

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1

Rivlerësimi i pasurisë së paluajtshme për individët

1. Të gjithë individët, të cilët kanë në pronësi pasuri të paluajtshme, kanë të drejtë që, nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri në datën 31 tetor 2013, të bëjnë rivlerësimin e kësaj pasurie me vlerën e tregut.

2. Ky rivlerësim mund të bëhet nga një ekspert i licencuar për vlerësimin e pasurisë së paluajtshme nga institucionet përkatëse ose nga zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

3. Në rast se individë zgjedh që të bëjë rivlerësimin me një ekspert të licencuar, atëherë aplikimi të tij për rivlerësim të pasurisë së paluajtshme i bashkëlidh edhe aktin e vlerësimit të ekspertit.

4. Zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme llogarisin diferencën ndërmjet çmimit të kontratës së regjistruar në këtë zyrë dhe vlerës së pasqyruar në aktekspertin, si dhe tarifën që duhet të paguajë individë për ta regjistruar këtë rivlerësim.

5. Në rast se individë zgjedh që rivlerësimi të kryhet nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme me çmimet minimale fiskale, atëherë ky fakt shprehet në aplikimin e tij për rivlerësim.

6. Në rastin e parashikuar në pikën 5 të këtij neni, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme llogarisin diferencën ndërmjet çmimit të kontratës së regjistruar në këtë zyrë dhe vlerës së dalë nga rivlerësimi me çmimet minimale fiskale, si dhe tarifën që duhet të paguajë shtetasi për të regjistruar këtë rivlerësim.

7. Tarifa, që paguhet për regjistrimin e këtij rivlerësimi, është 1% e diferencës ndërmjet vlerës së rivlerësimit me vlerën e kontratës së regjistruar në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

8. Në rastet kur pasuria e paluajtshme rezulton e regjistruar pa një kontratë shitjeje, atëherë, si vlerë regjistrimi, në zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, konsiderohet vlera e çmimeve minimale fiskale në çastin e regjistrimit.

9. Aplikimi bëhet sipas formularëve standardë, të miratuar me udhëzim të Ministrit të Financave.

10. Për shitjen e pasurisë të bërë pas rivlerësimit, tatimi llogaritet si diferencë e çmimit të shitjes dhe çmimit të dalë nga rivlerësimi.

Neni 2

Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet deri në datën 31 tetor 2013.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha